


Nr 5511/3 prot
13.11.2019



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI QARKU FIER

Këshilli
Majlinda Bufi
14.11.2019
Fier, më 11.11.2019

Nr/1507/3 Prot.

Fier, më 11.11.2019

Lënda: Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec.

Drejtuar: Znj. Majlinda **BUFI**
KRYETARE E BASHKISË ROSKOVEC.

ROSKOVEC

Për dijëni: Z. Kadri **HYSKA**
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC.

ROSKOVEC

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 5511/2 prot. datë 06.11.2019, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 1507/2 prot. Datë 08.11.2019, bazuar në Ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16, shqyrtuam vendimin e Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 88 datë 20.09.2019 "Për një shtesë në listën e inventarit, miratuar me VKM Nr. 241 datë 25.04.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Strum, të Qarkut të Fierit". Për verifikimin e ligjshmërisë së këtij vendimi me shkresën tonë Nr.1507/1 Prot. datë 02.10.2019 ju kemi kërkuar konfirmim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për statusin juridik aktual të pronës me Nr. rendor 163; Nr.Pasurie 90, objekt vendimmarrje.Prefekti i Qarkut Fier pasi u njoh me përgjigjen nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës konfirmon:

Vendimi Nr. 88 datë 20.09.2019 të Këshillit Bashkiak Roskovec "Për një shtesë në listën e inventarit, miratuar me VKM Nr. 241 datë 25.04.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Strum, të Qarkut të Fierit" Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 8 pika 2; neni 9 pika 1.2 shkronja "a"; Ligjin Nr.8743 datë 22.01.2001 "Për



Pronat e paluajtshme shtetërore” (i ndryshuar) si dhe në zbatim të VKM. Nr. 500 datë 14.08.2001

“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Baki BALA

